



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 08.06.2012, në orën 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula dhe Duda Balje.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

E ftuar: Safete Hadergjonaj- kryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Pjesëmarrës të tjerë: Bujar Kadriu-SHVPDK; Mexhit Foniqi-SHVPDK, Ilirjana Hamzaj-SHVPDK, Nuredin Ibishi- CDF; Burim Tahiri- praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Shqyrtimi i amendamenteve 9 dhe 22 të Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës.

Shqyrtimi i amendamenteve 9 dhe 22 të Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Kryetarja- I njoftoi anëtarët e Komisionit me permabjtjen e këtyre dy amendamenteve dhe meqë kemi disa paqartësi tha se duhet bërë harmonizimin e tyre. Për këtë kemi ftuar edhe kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, znj. Safete Hadergjonaj, të cilën e falënderoj që ka gjetur kohë të jetë në mbledhjen e Komisionit dhe lus kryetaren ta marrë fjalën për t' na dhënë sqarimet e nevojshme.

Safete Hadergjonaj, kryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa- Duke u ndërlidhur me amendamentin 9 tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar koston buxhetore të amendamenteve të paraqitura, dhe ka vërejtur se amendamentet 9 dhe 22 i Komisionit FunkSIONAL janë amendamente që kanë të bëjnë me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe po ashtu ligji në përgjithësi përmban kosto buxhetore. Ne kemi angazhuar edhe ekspertë që në mënyrën më të mirë analizojmë këto çështje. Ne nuk kemi dokument zyrtar me të cilin përcaktohet paga mesatare, kështu që do të ketë problem në përllogaritje, në kompensimin e kësaj kategorie, i vetmi dokument që ekziston dhe është si akt nënligjor është përcaktimi i pagesë minimale, të cilën e bën qeveria me një akt nënligjor dhe paga minimale caktohet me propozimin e këshillit ekonomik- fiskal dhe nga qeveria në bazë të këtij propozimi të këshillit ekonomik- social nxirret një vendim i cili përcakton pagën minimale. Ne, në Komision, e kemi vërejtur se paga minimale deri në 30 vjet është momentalisht 130 euro, kurse për personat prej 35 deri në 65 vjet është 170 euro. Në Komision na ka ardhur propozimi nga opozita që të ardhurat për këta persona të mos jenë më pak se 100 euro, dhe në bazë të këtyre kalkulimeve në pagën minimale 130 deri 170 euro edhe po të kishte kaluar 75% e pagës minimale të ardhurat munden me qenë edhe me pakë, se këto 100 euro, mendoj që propozimin që e kemi përkrahur unanimisht në Komisionin për buxhet është më i arsyeshëm dhe i favorshëm, si dhe të hiqet amendamenti 22, të mbetet neni 21, ashtu si është. Unë ju sugjeroj ta analizoni me kujdes propozimin:

„Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo me pak se 100 (njëqind) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria. Kompensimi indekssohet në rritjen e pagës minimale”. Ky është propozimi, dhe neni 21 e lejon këtë indeksim në rast të ndryshimit të koston jetësore.

Rita Hajzeraj- tha se Personat e verbër e kanë pranuar të jetë një kompensim i pranueshëm në pajtueshmëri me mundësit buxhetore, dhe kemi ardhur në përfundim se duhet të caktohet në përqindje, në bazë të pagës minimale. Ju e keni dhënë propozimin tuaj dhe u tha se, kompensimi indekssohet në rritjen e pagës minimale. Më intereson të dijë se qysh do të bëhet indeksimi i rritjes së pagës minimale. Ju e

cekët në seancë se janë dy standarde të përcaktimit të pagës minimale, unë e di se është një standard.

Grupi parlamentar i LDK-së është dakord me atë nëse pajtohet edhe vetë shoqata e personave të verbër.

Safete Hadergjonaj- Tha se në emër të Komisionit kemi angazhuar edhe ekspertë. Ligji për pagat e shërbyesve civilë zakonisht i rregullon këto çështje, vendimi i qeverisë Nr. 04/33 i datës 17.03.2011 e thotë këtë që e thashë më lart. Unë bazohem në vendimin e qeverisë që është në fuqi ende.

Kryetarja- Tha se ky vendim i qeverisë ka elemente diskriminuese, sepse po i përcakton dy kategori, por nuk mund ta ndryshojmë ne, sepse është vendim i qeverisë dhe është në fuqi.

Safete Hadergjonaj- lidhur me këtë tha, se këtu ka dhënë një propozim këshilli ekonomiko- fiskal, dhe dihet kush ka qenë prezent. Aty kanë qenë prezent kategori të ndryshme, dhe në bazë të kësaj është hartuar edhe vendimi i qeverisë. Janë disa rregulla në bazë të se cilës përcaktohen paga minimale dhe nuk mund t'ju shmangemi.

Kymete Bajraktari- duke u ndërlidhur me këtë propozim tha se kur thuhet se kompensimi është jo më pak se 100 euro, sa është kjo vlerë, a duhet të përcaktohet, si dhe te neni 22 kush garanton që neni 22 në të ardhmen do të implementohet? Domethënë vlera do të rritet në bazë të inflacionit.

Safete Hadergjonaj- Theksoi se zbatimin e këtyre e garanton ligji. Unë këtu para jush nuk po e paraqes mendimin tim personal, por po e paraqes mendimin e Komisionit, mendimin e 11 deputetëve dhe po e paraqes në bazë të asaj çka është e planifikuar në buxhet. Ne duhet bërë një ligj që është i zbatueshëm, e jo ligj që do të ketë pengesa nga më të ndryshmet në të ardhmen dhe nuk do të jetë i zbatueshëm asnjëherë.

Kymete Bajraktari- Tha se nuk e kam të qartë sa do të jetë ky kompensim saktë, a ka me qenë fiks 100 euro, apo qysh do të përcaktohet shuma?

Safete Hadergjonaj- Tha se nuk është fikse, sepse vetë fakti që thotë, jo më pak se 100 euro, nuk është pagë fikse, nuk guxon të bjerë nën 100 euro, por mund të jetë më e madhe se kjo.

Kryetarja- Tha se kufiri minimal është 100 euro, por nuk do të thotë se nuk mund të rritet kjo shumë, është e qartë se nuk mund të ulet, por për rritje ka mundësi.

Kurtan Kajtazi- Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se kur diskutohet për këtë kategori të personave është një çështje e ndjeshme dhe duhet të kihet kujdes. Unë e kam thënë edhe dje se mosha deri nën 35 vjet në Kosovë është mbi 60% e popullatës

së përgjithshme. Me vendimin e djeshëm do të dëmtoheshin shumë më shumë moshat e tjera dhe kishte lënë mundësi për mos rritje të ardhurave, ndërsa kjo që është jo me pak se 100 euro lë mundësi për rritje të ardhurave.

Kryetarja- Tha se edhe shoqata pajtohet të jetë riformulimi i nenit 7.2 kështu: „Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo me pak se 100 (njëqind) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria. Kompensimi indeksuhet në rritjen e pagës minimale”.

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv, që zhvilloi Komisioni lidhur me harmonizimin e qëndrimeve me sugjerimet e dhëna nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni FunkSIONAL, pas një votimi me 5 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim nxori këtë:

Përfundim

I. Komisioni vendosi që të mbështetet amendamenti 9 i Komisionit për Buxhet dhe Financa me këtë përmbajtje: „ Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensim në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo me pak se 100 (njëqind) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria. Kompensimi indeksuhet në rritjen e pagesë minimale.”

II. Komisioni tërhiqet nga amendamenti 22 dhe neni 21 që të kthehet si në projektligj.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali